

EMERGJENCA KORONAVIRUS
DEKRET I PRESIDENTIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
4 MARS 2020 – SHTOJCA 1
MASAT HIGJIENIKO-SHËNDETËSORE:

- a) lani shpesh duart. Rekomandohet vënia në dispozicion në të gjitha lokalet publike, palestrat, supermarketet, farmacitë e vendet e tjera ku grumbullohen njerëz, solucione hidro-alkoolike për larjen e duarve;
- b) shmangni kontaktin e ngushtë me persona që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes e gjithsesi shmangni përqafimet, shtrëngimin e duarve dhe kontaktet fizike të drejtpërdrejta me çdo person;
- c) higjiena e frymëmarrjes (teshtini ose kollituni në një shami duke shmangur kontaktin e duarve me sekrecionet e frymëmarrjes);
- d) mbani në çdo kontakt social një distancë ndërpersonale të paktën një metër;
- e) shmangni përdorimin e përzier të shisheve e të gotave, edhe gjatë aktivitetit sportiv;
- f) mos prekni me duar sytë, hundën e gojën;
- g) mbuloni gojën e hundën nëse teshtini ose kolliteni;
- h) mos përdorni ilaçe antivirale e antibiotikë, përveç rasteve kur jepen nga mjeku;
- i) pastroni sipërfaqet me dezinfektues me bazë klori ose alkooli;
- l) përdorni maskë vetëm nëse dyshoni që jeni sëmurë ose asistoni persona të sëmurë.